



Të rinjtë në Pogradec promovojnë



Paqe, Dialog dhe Tolerancë



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania

Projekti po zbatohet me mbështetjen financiare të  
Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të  
Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë

Projekti “Të rinjtë në Pogradec promovues të Paqes, Dialogut dhe Tolerancës fetare” synon promovimin e aktivizmit të të rinjve dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në Bashkinë Pogradec përmes kryerjes së aktiviteteve përgjatë një viti.

### **Objektivat**

-Përmirësimi i aftësive dhe përgjegjshmërisë së aktorëve lokalë për të parandaluar dhe sfiduar fenomenet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes trajnimesh.

-Ndërtimi i rezilencës së të rinjve përmes përfshirjes së shtuar në aktivitete edukative dhe të shëndetshme jashtëshkollore.

-Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit përmes një seri aktivitetsesh të bazuara në komunitet në lidhje me rreziqet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

### **Rezultatet**

-Aktorët lokalë të aftë për të bashkëpunuar dhe për të përballuar fenomenin e ekstremizmit

-Të rinjtë aktivë dhe të edukuar me frymën e debatit, të mendimit kritik, tolerancës dhe kulturës së paqes

-Komuniteti i ndjeshëm që reagon përgjigjet ndaj fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit

Pjesëmarrësit në fund të projektit do të jenë të aftë:

- Të kuptojnë si të identifikojnë të rinjtë në rrezik për t'u përfshirë në sjellje të dhunshme dhe në lëvizje radikale;
- Të zhvillojnë aftësi se si të ndihmojnë këta të rinj të përfshihen në aktivitete të shëndetshme;
- Të mbështesin të rinjtë të kuptojnë teknikat kryesore në menaxhimin paqësor të konflikteve të tilla si ndërmjetësimi;
- Të mobilizojnë të rinjtë në rrezik në aktivitete të tilla si: Shërbime komunitare, Aktivitete sportive, Klube debati etj.
- Të planifikojnë se si të parandalojnë dhe të përballen me fenomenin e radikalizmit.



# Fjalor i termave që lidhen me fenomenin e

**Radikal** -rrënjësor, radikal për një ndryshim ose veprim që lidhet ose prek natyrën themelore të diçkaje.

**Radikalizim** -Procesi i zhvillimit të ideologjive dhe pikëpamjeve ekstremiste. Radikalizimi mund të jetë i dhunshëm ose jo.

**Radikalizimi në dhunë** -një vendim për të anashkaluar proceset politike apo metodat jo të dhunshme të nxitjes së ndryshimit, duke favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme për të sjellë ndryshimin.

**Kundëradikalizimi** -një paketë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t'i frenuar individët e pakënaqur (dhe, me gjasë, tashmë të radikalizuar) që t'i drejtohen terrorizmit.

**Ekstremizëm** -Tërësia e pikëpamjeve më të skajshme ..., prirje për të bërë kërkesa dhe për të kryer veprime që e kalojnë çdo masë; skajshmëri. (fjalori i gjuhës së sotme shqipe, botimi 1980)

**Ekstremizëm i dhunshëm** -përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politikë.

**Ekstremist** -Person i cili aplikon format e dhunshme për të bindur forcërisht të tjerët mbi të njëjtat qëndrime të tejskajshme, të cilat mbron, mbart dhe promovon ai.

**Qëndresë** -Aftësia dhe prirjet e dikujt për të qëndruar i palëkundur ndaj një vështirësie, problemi apo fenomeni ose dukurie. Gjithashtu kuptojmë faktorët, idetë, institucionet, çështjet, prirjet ose vlerat që iu japin mundësi individëve dhe komuniteteve t'i bëjnë qëndresë dhunës ose ta parandalojnë atë.

**Luftëtarë të huaj terroristë** -individë që udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i

# radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin apo pjesëmarrjen në akte terroriste ose ofrimin a përftimin e trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur.

**Doktrinë** (vjen nga latinishtja: mësim; teori) dhe është një sistem, një tërësi pikëpamjesh që mendohen të kenë vlefshmëri të përgjithshme.

**Indoktrinim:** Të mësosh një person ose grup të pranojë në formë jo kritike një tërësi pikëpamjesh.



## Ekstremizmi i dhunshëm dhe Media Sociale

Përdorimi i mediave sociale nga ekstremistët e dhunshëm shpesh është i sofistikuar në aspektin e manipulimit dhe kryesisht lidhen me propagandën, kërcënimin, rekrutimin dhe mbledhjen e fondeve.

Ekstremistët e dhunshëm krijojnë platforma tërheqëse dhe interaktive për të tërhequr të rinjtë. Ata shpërndajnë materiale me përmbajtje ekstremiste, të dhunshme dhe kriminale, të cilat nuk do të qarkullonin lehtësisht offline. Gjithashtu bëjnë publicitet masiv për aktet e dhunës, që ato të perceptohen si Fuqi. Ata përpiqen të krijojnë një komunikim intim 24-orësh që synon zhvillimin e marrëdhënieve të “bashkëpunimit dhe miqësisë”, ku ideologjia e dhunshme krijon lidhje të forta ndërpersonale.

Kujdes! Mos u bëj pre e manipulimit!

## Të dashur nxënës!

Ju ftojmë të bëheni pjesë aktive e projektit “Të rinjtë në Pogradec promovues të Paqes, Dialogut dhe Tolerancës fetare”.

Pyesni mësuesin kujdestar apo psikologun e shkollës për aktivitetet që po zhvillohen në shkollën tuaj.

Regjistrohuni në klubet e debatit, klubet sportive, lexoni librat më të rinj që kanë ardhur pranë bibliotekës së shkollës, merrni pjesë në diskutimet rreth tyre.

Ju mund të shkruani ese, të realizoni postera dhe video sensibilizuese me shokët dhe shoqet e klasës.

Ne theksojmë se është e rëndësishme të pasurohen nxënësit me mjetet e duhura për t'u mbrojtur kundër sharlatanëve dhe personave “guru”, për t'i kapërcyer rreziqet që u vijnë nga ta, për t'u ndërgjegjësuar lidhur me rrëshqitjet e ndryshme politike dhe sociale që mund të ndodhin në çdo moment.

Ne duam t'i ndihmojmë të rinjtë në përvetësimin e një mënyre të tillë të menduari që ata të orientohen në një shoqëri pluraliste, pa kufij, brenda raportesh njerëzore me kode të shumta, në një shoqëri ngritur mbi informatizimin e informacionit, që duhet të kuptohet, analizohet, përgjithësohet, vlerësohet dhe rinovohet.

Ne duam t'i edukojmë të rinjtë, që përdorin masivisht mediat sociale, në lidhje me sjelljen etike online, çështjet e privatësisë dhe rreziqet që lidhen me zbulimin e të dhënave personale, si të njohin dhe shënjestrojnë abuzimet terroriste të rrjeteve sociale.

Ne besojmë se të gjithë së bashku, nxënës, prindër, mësues, banorë dhe aktivistë të shoqërisë civile do të krijojmë një model të një shoqërie pa dhunë, ku konfliktet zgjidhen me anë të debatit, komunikimit, dialogut, mirëkuptimit, tolerancës, sepse një shoqëri demokratike është ajo shoqëri që inspiron për paqe!

Shoqata “Unë, Gruaja”, Pogradec

## Shkollat ku do të zbatohet projekti: Të rinjtë promovues të Paqes, Dialogut dhe Tolerancës



Shkolla e mesme  
"14 Engjëjt", Buçimas



Shkolla e mesme  
"Muharrem Çollaku", Pogradec



Shkolla e mesme  
"Gjergj Pekmezi", Pogradec





Shkolla e mesme  
"Qemal Bazelli", Çërravë



Shkolla e mesme  
"Dëshmorët e Pojskës", Udënisht

Për më shumë informacion na kontaktoni:

Shoqata "Unë, Gruaja", Pogradec

 <https://www.facebook.com/unegruaja/>;  Nxitesit e Debatit Pogradec (grup)

Vizitoni **blogun** në: <https://www.unegruaja.org.al/blog/>

YouTube: Shoqata Une Gruaja



[www.unegruaja.org.al](http://www.unegruaja.org.al)



Shoqata Une, Gruaja



[une\\_gruaja@yahoo.com](mailto:une_gruaja@yahoo.com)



0676470005



+355 832 22140



Rr. Reshit Çollaku, Pogradec

Ky botim u realizua nga Shoqata "Unë, Gruaja" Pogradec.

Me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.